



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 6/12/4 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 6/12/4 i Vendimit**

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Ilir Panda	Kryesues
Sokol Sadushi	Anëtar
Ervin Pupe	Anëtar

sot, më datë 24.06.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Albert Golemi

OBJEKTI : Konstatim i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të gjyqimit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 399/5 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen penale që i përket:

I GJYKUAR: Albert Golemi

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Mashtrim me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATES SE LARTE

pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Ilir Panda dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes.

1. Me kërkesën e regjistruar në Gjykatën e Lartë, me nr. 581 prot, datë 19.2.2021, pala kërkuese Albert Golemi, në referim të nenit 399/5 të Kodit të Procedurës Civile, kërkon konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me çështjen penale, të regjistruar pranë kësaj gjykate, me nr. 53201-01449-00-2018, datë 11.9.2018.

1.1. Me shkresën nr. 581/1 prot, datë 22.2.2021, të Kancelarit në detyrë të Gjykatës së Lartë kërkesa është kthyer për plotësim, pasi është konstatuar se është paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 474 të Kodit të Procedurës Civile dhe pas plotësimit të saj, kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Lartë, më nr. 1535 prot, datë 11.5.2021.

2. Nga aktet rezulton se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në kuadër të procedimit penal nr.83/2017, ka shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit Albert Golemi dhe në përfundim të gjykimit të zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, me vendimin 11-2017-6541/795, datë 22/12/2017, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Albert Golemi për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, në aplikim të nenit 406 të KPP, e ka dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim.

3. Mbi apelin e të pandehurit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 328, datë 3.7.2018, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit penal nr.11-2017-6541/795, datë 22/12/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

4. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë i gjykuari Albert Golemi, çështje e cila është regjistruar në 53201-01449-00-2018, datë 11.9.2018.

5. Në kërkesën e tij kërkuesi parashtron se vendimet e gjykatave objekt rekursi janë të pavlefshme, pasi janë marrë në shkëlje të rënda të KPP dhe KEDNJ, shkëlje të cilat i ka parashtruar në rekursin e paraqitur prej tij; i është nënshtruar ekzekutimit të një vendimi të paligjshëm dhe aktualisht është duke vuajtur dënimin me burgim që nga data 4.1.2019 në IEVP-Fier. Sipas kërkuesit, afati i shqyrtimit të çështjes së tij është tejkaluar, sipas parashikimeve të nenit 399/6, pika “1” të KPC edhe pse është i vetëdijshëm për vonesat objektive që ekzistojnë për gjykimet e çështjeve në Gjykatën e Lartë. Për këto arsye, kërkon përshpejtimin e procedurave gjyqësore në Gjykatën e Lartë për çështjen objekt kërkesë.

6. Në përputhje me nenin 399/4, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kërkoi informacion nga gjyqtari relator në lidhje me fazën dhe procedurat e gjykimit të kësaj çështje.

7. Në mendimin me shkrim të gjyqtarit relator të çështjes, lidhur me kërkesën e paraqitur, parashtrohet se, pavarësisht se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 11.9.2018, në ngarkim të këtij gjyqtari është caktuar me shortin e datës 12.5.2021. Çështja është në fazë studimi dhe nuk është caktuar ende data e shqyrtimit të saj, për shkak të numurit të madh të dosjeve të tjera në radhë në ngarkim të tij, (mbi 1000 çështje penale) të regjistruara në vitet 2013-2018. Për shkak të rrethanave objektive të cituara më sipër, nuk është përmbushur afati i arsyeshëm për shqyrtimin e kësaj çështje.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga subjekti i legjitimuar. Kërkuesi Albert Golemi, rezulton të jenë në cilësinë e të gjykuarit në procesin penal për të cilin është regjistruar rekursi me nr. regj. 53201-01449-00-2018, datë 11.9.2018, në Gjykatën e Lartë.

9. Kërkesa është në kompetencën e këtij Kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi nëpërmjet saj kërkohet konstatimi i shkëljes së afatit të

arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë. Kërkesa i plotëson elementet e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile.

10. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ/penal, pasi përbën dhe një nga elementet e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatin “*Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*)

11. Kolegji çmon të theksojë praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimin të çështjes.

12. Në vijim të jurisprudencës së konsoliduar, GJEDNJ ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të kësaj jurisprudence rezulton se në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjelici kundër Sllovenisë ap. nr. 50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*)

13. Kolegji vlerëson se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes merr në konsideratë të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*)

14. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, Kolegji çmon se ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit, dilijencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, vlerëson gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, dt. 15.07.1982 të GJEDNJ*)

15. Kolegji vlerëson se për sa për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje p.sh.: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkakuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve

penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Ewing kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

20. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se, në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë, çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Lartë, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile (1 vit), pasi nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Lartë dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë ka kaluar një kohë afërsisht 2 vjet e gjysëm.

21. Duke marrë në vlerësim standardet e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me afatin arsyeshëm, nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese apo të jenë kryer veprime të tjera që të kenë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që, nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë deri në këto momente, nuk është kryer asnjë veprim procedural.

22. Kolegji vlerëson se në lidhje me mosveprimin e gjykatës që nga momenti i caktimit të çështjes, deri në datën që kërkuesi ka paraqitur kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të shqyrtimit, duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit të çështjes. Në rastin konkret, nga momenti i regjistrimit të rekursit/çështjes në Gjykatën e Lartë, ka rezultuar se gjyqtari relator është ndryshuar disa herë, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për shkak të plotësimit të Gjykatës së Lartë me gjyqtarë të tjerë apo për shkaqe të tjera objektive të parashikuara nga ligji. Pas rishortimit të fundit të çështjeve me datë 12.5.2021, kjo çështje ka kaluar në ngarkim të gjyqtarit që e ka në shqyrtim aktualisht, i cili pasi u njoh me kërkesën, ka depozituar me datë 4.6.2021 mendim me shkrim, në të cilën ka parashtruar se për këtë çështje do të ndiqet radha si për të gjithë çështjet e tjera, pasi si gjyqtar relator dhe anëtar në Kolegjet e Gjykatës së Lartë, kanë ngarkesë të madhe çështjesh (rreth 1000) të cilat presin për gjykim.

23. Kolegji vlerëson se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes konkrete objekt gjykimi është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë. Ky proces natyrisht ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që padyshim krijon procesi i reformës.

24. Komisioni i Venecias ka theksuar se reforma në drejtësi, përfshirë procesin e verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri, ishte e domosdoshme edhe nëse do të sillte pasoja të paparashikuara. Përveç aspekteve të padyshimta pozitive mbi cilësinë e gjyqësorit në planin afatgjatë, në një periudhë afatshkurtër procesi i verifikimit ndikon në numrin e gjyqtarëve aktiv në sistem duke shkaktuar probleme të përkohshme praktike derisa të bëhet zëvendësimi i tyre (*Shih European Commission for Democracy through law (Venice Commission) Albania) opinion on the appointment of judges to the Constitutional Court*).

25. Kolegji vlerëson se rrethanat e mësipërme janë pasur në vëmendje edhe nga ligjvënësi në kohën e miratimit të ndryshimeve ligjore, konkretisht me ligjin nr. 38/2017 të Kodit të Procedurës Civile duke parashikuar Kreun X “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”. Neni 399/2, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është

shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.”. Kolegji çmon se legjislatori, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile, ka parashikuar shprehimisht rrethanat e pamundësisë objektive për llogaritjen e afateve në kohëzgjatjen e gjykimit si një shkak objektiv që shkarkon nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit të fiksuar në nenin 399/2, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile.

26. Për sa më sipër, rezulton se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Rezulton se shqyrtimi i tyre bëhet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Kolegji, duke marrë në konsideratë rastet që GJEDNJ ka përcaktuar se çfarë përbën sjellje të gjykatës, e cila ndikon në cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, vlerësohet se rastet kur gjykata është në pamundësi objektive dhe pa vullnetin e saj për të gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë, shkurtimit të numrit të gjyqtarëve në sistem, nuk përbëjnë cenim të këtij standardi. Gjyqtari relator ka marrë të gjitha masat e nevojshme duke përcaktuar dhe kritere transparente për trajtimin sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar në cilësinë e gjyqtarit relator.

27. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt ligjor dhe e vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për sasinë e afatit të arsyeshëm apo edhe ekonominë gjyqësore në tërësi.

28. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës së kërkuesit/të gjykuarit Albet Golemi, me objekt: Konstatim i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të gjykimit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e saj nga gjyqtari relator.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe nenin 299, 399/8 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Albert Golemi.

Tiranë, më 24.06.2021.

ANËTAR

Ervin PUPE

ANËTAR

Sokol SADUSHI

KRYESUES

Ilir PANDA